

INSPEKTORATI SHITËTËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL						
Regjistri i Kërkesave/Ankesave dhe Përgjigjeve ISHTI GUSHT 2025						
Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e Përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	31.07.2025	Kërkohej informacion përsa i përket ndorjes mjedisore dhe dëmit në shëndetin e banorëve të afro 10 fshatrave përreth saj. Një fabrikë tullash operon tanimë prej vitesh dhe ndorja alarmante që bën kjo fabrikë (kryesisht puna më voluminante kryhet natën ku tymi vërehet shumë qartazi i cili përhapet në të gjitha zonat përreth) po kërcënon seriozisht shëndetin tonë por me e rëndësishmja e fëmijëve tanë që po rriten në këtë ajër kancerogjen. Me herët me datë 29/03/2024 ju kemi dërguar një kërkesë me shkrim drejtuar të gjitha institucioneve por pa marrë asnjë përgjigje pozitive. Po e ridergoj serisht kërkesën më poshtë me dokument si dhe disa video dhe foto të ajrit të ndotur që kjo fabrikë prodhon.	06.08.2025	Në përgjigje të Ankesës me Nr.çështje 913705 datë 31.07.2025, ardhur pranë ISHTI-t me Nr. 6997-Prot datë 31.07.2025, ju bëjmë me dije se u ushtrua kontroll nga inspektorët e ISHTI-it në zbatim të Autorizimit Nr.7112 Prot, datë 04.08.2025, Nga inspektimi i kryer pranë këtij subjekti, u konstatua se ky subjekt kishte në përdorim pajisje nën presion specifkëshit; 1 Rezervuar Gln, 1 Kaldajë dhe 6 Rezervuar Ajri, për të cilat disponon dokumentacionin tekniko-ligjor si më poshtë vijon; -Projektin Teknologjik të instalimit të pajisjeve/instalimeve nën presion -Çertifikatat e Konformitetit të Vërtetimit të Përputhshmërisë të Projektit Teknik të Pajisjeve/Instalimeve nën Presion, - Aktin Teknik të Montimit - Pajisjet/Instalimet nën Presion ishin të pajisura me Deklaraten CE të Konformitetit - Subjekti dispononte Çertifikatë Kualifikimi për përdorimin e pajisjeve/instalimeve nën presion Çertifikatat e Inspektimit të Konformitetit Polica Sigurimit e Përgjegjësisë Civile Përsa më sipër subjekti disponon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm tekniko-ligjorë për përdorimin e pajiseve nën presion si dhe këto pajisje (PNP) plotësojnë kushtet thelbësore të sigurisë në zbatim të Ligjit 32 datë 24.03.2016 “Për garantimin e sigurisë së punës së pajiseve dhe instalimeve nën presion”.	E plotë	0
2	04.08.2025	Ankesë për disa bombola gazi ne sherbim te subjekti qe perbejne rrezik per banoret.	06.08.2025	Në përgjigje të ankesës tuaj dërguar me email Nr.7231 Prot, datë 04.08.2025, ju bëjmë me dije se u u shtrua kontroll nga inspektorët e ISHTI-it në zbatim të Autorizimit Nr. 7231/1 Prot, datë 05.08.2025 në subjekt Subjekti i mësipërm është i regjistruar në QKB Nga inspektimi i kryer pranë këtij subjekti, u konstatua se ky subjekt për pregatitjen e ushqimit përdorte sobë gazi që furnizohej prej bombolave të GLN-s (gazit). Bombolat e GLN-s ishin të instaluara jo në guzhinë por jashtë ndërtesës, në faqe të murit të ndërtesës, brenda një kafazi metalike.Bombolat e GLN-s bashkoheshin me një kolektor të përbashkët dhe nëpërmjet një tubi metalik dhe kolektorëve përkatës përcillej në vatrat e sobës. Në instalim e bombolave të GLN-s gjendej i montuar sinjalizuesi në ambientin e brendshëm për rastin kur ka rjedhje gazi si dhe autoblokuksi në kolektorin e jashtëm, pra në dalje të bombolave të GLN-s . Pra subjekti ka të instaluar pajisje nën presion të transportueshme, që janë katër bombola GLN-je me peshë mbajtëse secila nga 25 kg. Subjekti për këto pajisje nën presion disponon dokumentacionin tekniko ligjor si më poshtë: - Projektin teknik të instalimit të bombolave të GLN-s - Vlerësimin e konformitetit të projektit teknik të instalimit të bombolave të GLN-s -Aktin teknik të montimit, pra i instalimit të bombolave të GLN-s - Ka kontratë të sigurimit të përgjegjësisë për palë të treta - Bombolat e GLN-s janë brenda afatit të inspektimit teknik, pra janë të kolauduara. - Ka kontratë furnizimi të bombolave të GLN-s nga një shoqëri për furnizimin e tyre. Përsa më sipër, theksojmë se subjekti disponon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm tekniko-ligjorë për përdorimin e pajiseve nën presion si dhe këto pajisje (PNP) plotësojnë kushtet thelbësore të sigurisë në zbatim të Ligjit 32 datë 24.03.2016 “Për garantimin e sigurisë së punës së paisjeve dhe instalimeve nën presion”. Subjektit ju janë rekomandime që bombolat e GLN-s të cilat do të përdoren në vazhdimësi, pra kur të zëvendësohen duhet të jenë gjithmonë brenda afatit të inspektimit teknik periodik, të jenë të inspektuara nga një OMI (Organ i Miratuar i Vlerësimit të Konformitetit) si dhe të instaluara sipas projektit teknik.	E plotë	0
3	04.08.2025	Kërkohej informacion ne lidhje me nje karburant. Ju lutem para se te ndodhi ndonje katastrofe si ne itali merni masa sepse jemi te detyruar te kalojme permes karburantit per te kaluar rrugen , si une dhe te gjithe banoret e zones. Nderkohe qe aty vjen furnizimi me gaz me bot ne cdo ore te dites. Kemi frike te kalojme Nderkohe mbushin makinat me gaz .ju lutem merni masa, te pakten te gjejne nje orar te pershtatshem kur vjen per ta furnizuar boti me gaz.	11.08.2025	Në përgjigje të kërkesës me email me datë 04.08.2025 nga zyra e bashkëqeverisjes “Shqipëria që duam” me numër çështje 911008, Protokolluar në ISHTI me Nr. 7110 Prot datë 04.08.2025, në vijim të shqetësimit të një qytetari në lidhje me një karburant, mbi furnizimin e stacionit të shitjes së karburanteve nga autoçisternat me gaz të lënëzuar nga nafta (GLN) si dhe furnizimin e automjeteve me GLN, ju informojmë si më poshtë: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është organi shtetëror i specializuar për kontrollin e veprimtarisë së personave juridikë që kryejnë veprimtari në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregimit të naftës dhe nënprodukteve të tyre në zbatim të ligjit nr. 8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar; ligjit nr. 99/2024 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në vijim të ankesës së dërguar, Inspektorët e ISHTI të pajisur me Autorizim Inspektimi Jashtë Programit me datë 08.08.2025 kanë inspektuar stacionin e shitjes së karburanteve Nga inspektimi i kryer rezultoi se nuk ka shkelje të kërkesave ligjore. Subjektit i është lënë detyrë që të zbatoj me rigorozitet kërkesat teknike gjatë shkarkimit të autoçisternave për karburantet dhe GLN. Bëjmë me dije se stacioni i shitjes me pakicë të karburanteve është inspektuar me datë 11.07.2025 sipas Programit vjetor dhe mujorë të miratuarua ku rezultoi se nuk ka shkelje të kërkesave ligjore. - Ka kontratë furnizimi të bombolave të GLN-s nga një shoqëri për furnizimin e tyre. Përsa më sipër, theksojmë se subjekti disponon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm tekniko-ligjorë për përdorimin e pajiseve nën presion si dhe këto pajisje (PNP) plotësojnë kushtet thelbësore të sigurisë në zbatim të Ligjit 32 datë 24.03.2016 “Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion”.	E plotë	0
4	25.08.2025	Kërkohej informacion lidhur me pajisjen me Deklarate konformitetit dhe certifikate nga Organet e Miratuara te Vleresimit te Konformitetit. Kerkojme te marrim leje per zhvillim aktiviteti ne Bashkine Tirane por kerkohen dhe keto dokumentat dhe nuk kemi informacion si procedohet. Ju lutem na udhezoni cfare duhet tju sjellim qe te marrim keto dokumenta per lejen ?	25.08.2025	Në përgjigje të e-mailit tuaj lidhur me kërkesën për informacion, mbi pajisjen me Deklaratë konformiteti dhe certifikatë nga Organet e Miratuara për Vlerësim të Konformitetit, ju bëjmë me dije se, Listën e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK) të miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) e gjeni të shpallur në faqen zyrtare të ministrisë. Bashkëlidhur linku, https://www.infrastruktura.gov.al/siguria-teknike-dhe-mbikexyryja-e-tregut/	E plotë	0

